



REPUBLIKA E KOSOVËS
ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Nr. i Dokumentit: 24.29.1-2014-08

RAPORTI I AUDITIMIT
PËR PASQYRAT FINANCIARE TË AUTORITETIT TË AVIACIONIT
CIVIL PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2014

Prishtinë, Qershor 2015

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës. Auditori i Përgjithshëm në Detyrë është kreu i Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, i cili ka rreth 145 të punësuar. Auditori i Përgjithshëm dhe Zyra e Auditorit të Përgjithshëm janë të pavarur dhe certifikon rreth 90 Pasqyra Vjetore Financiare çdo vit, derisa ndërmarrin forma të tjera të auditimit.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhim të shëndoshë financiar në administratë publike. Ne do të kryejmë auditime cilësore në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik dhe praktikat e mira evropiane. Ne do të ndërtojmë besim në shpenzimin e fondeve publike. Ne do të luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe palëve tjerë të interesit në rritjen e llogaridhënies publike.

Raportet e nxjerra nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien pasi ato ofrojnë bazë për ti kërkuar llogari menaxherëve të çdo organizate buxhetore.

Auditori i Përgjithshëm në Detyrë ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit dhe raportin mbi Pasqyrat Vjetore Financiare të Autoritetit të Aviacionit Civil në konsultim me Asistent Auditorin e Përgjithshëm, Ibrahim Gjylderen, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinioni i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nën menaxhimin e Drejtorit të Auditimit, Zukë Zuka, i mbështetur nga Valbona Tolaj (Udhëheqës Ekipi), Hysen Boqolli anëtar.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia	6
2 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	8
3 Rekomandimet e vitit paraprak.....	9
4 Qeverisja.....	10
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP	19
Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak	22


Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi ynë i pasqyrave vjetore financiare (PVF-të) për vitin 2014 i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm në detyrë. Unë do të doja të falënderoja Drejtorin e Përgjithshëm të Autoritetit të Aviacionit Civil dhe stafin e tij për ndihmën e tyre gjatë procesit të auditimit.

Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2014 u ndërmor në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtarisht të auditimit në Sektorit Publik (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ne menduam se ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e ndërmarrë është paraqitur në Memon e Planifikimit të Auditimit, Shtator 2014.

Auditimi ynë është fokusuar në:



Niveli i punës së kryer nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm për të përfunduar auditimin për vitin 2014 pasqyron drejtpërsëdrejti cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti.

Opinion

Shtojca I shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ana e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm është:

Opinion i Pamodifikuar

Sipas opinionit tonë pasqyrat financiare prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale (SNISA 200/1700 Opinion i Pamodifikuar).

Konkluzioni i përgjithshëm


Bazuar në detajet e paraqitura në secilën pjesë të këtij raporti, konkluzioni ynë i përgjithshëm është se:

Ne ishim në gjendje të marrim siguri në funksionimin efektiv të kontrolleve menaxheriale në disa fusha, por kemi identifikuar dhe disa dobësi në fusha të menaxhimit financiar. Dobësitë janë të shpjeguara më në detaje në brendi të raportit.

Rekomandimet e auditimit kanë për qëllim të mbështesin menaxhmentin e Autoritetit të Aviacionit Civil në përmirësimin e kontrolleve financiare dhe aktiviteteve operationale. Ne kemi konsideruar përgjigjet ndaj rekomandimit tonë të bërë për vitin 2013 i cili është implementuar.

Kemi diskutuar cilësinë e raportimit financiar të Autoritetit të Aviacionit Civil për të gjeturat tona, si dhe për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin në pjesën kryesore të këtij raporti.

Konkluzionet dhe rekomandimet tona kryesore janë:



Përgjigja e Drejtorit të përgjithshëm- auditimi 2014

Të gjeturat e detajuara dhe konkluzionet e auditimit në këtë raport janë marrë në konsideratë nga Drejtori i përgjithshëm. Për të gjitha çështjet e ngritura në këtë raport Drejtori i përgjithshëm është pajtuar.

1 Fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia

Është përgjegjësi e Autoritetit të Aviacionit Civil (AAC) të përgatis pasqyrat vjetore financiare (PVF) sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik (SNKSP) për “Raportimin Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme” dhe kërkesave të tjera specifike. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare si dhe të shprehemi:

- nëse PVF japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Ne kemi shqyrtuar kontrollet menaxheriale, për të përcaktuar shkallen deri ku mund të mbështetemi në to, për përcaktimin e testimit të hollësishëm, i cili është i nevojshëm për të siguruar nivelin e nevojshëm të dëshmimeve, për të mbështetur opinionin e Auditorit të Përgjithshëm (AP). Aktivitetet e menaxhmentit përcatojnë edhe fokusin e auditimit tonë të pajtueshmërisë dhe auditimit të qeverisjes së mirë të cilat nuk kanë ndikim të drejtpërdrejtë në opinion.

Qasja jonë audituese ndaj qeverisjes fokusohet në vlerësimin e veprimeve të ndërmarra nga menaxhmenti me qëllimin për të siguruar menaxhim financiar dhe kontroll efektiv si dhe në vlerësimin e rezultateve të këtyre veprimeve në ofrimin e produkteve operative në mënyrë cilësore. Për sistemet individuale financiare, ne kërkojmë të identifikojmë nivelin në të cilin funksionojnë kontrollet aktuale. Shembull i një aktiviteti mund të jetë monitorimi i ndërmarrë nga menaxhmenti ose nga nivele më të ulëta të kontrolleve operative. Ne konsiderojmë nëse kontrollet janë të dizajnuara mirë, nëse janë implementuar sipas planit dhe nëse operojnë në mënyrë efektive. Kjo kërkon një vlerësim të strukturave, proceseve dhe linjave të llogaridhënies të prezantuara nga menaxhmenti, përfshirë këtu edhe rolin e Auditimit të Brendshëm dhe të Komitetit të Auditimit si dhe kontrollet e brendshme të sistemit.

Pjesët e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit. Një vlerësim i mënyrës se si Menaxhmenti i ka adresuar rekomandimet e bëra në vitin 2013 mund të gjendet në Shtojcën II.

Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuar gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Te gjeturat tona janë definuar si:

Të prioritetit të lartë - Çështje të cilat mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

Të prioritetit të mesëm - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Të gjeturat që konsiderohen si me prioritet të ulët do të raportohen veçmas stafit të financave.

Procedurat tona kanë përfshirë një rishikim të kontrolleve të brendshme dhe sistemeve të kontabilitetit dhe teste substanciale të shoqëruara me to vetëm deri në atë masë që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive që ekzistojnë, apo edhe të të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë funksionuar.

2 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Përshkrimi

Rishikimi ynë i PVF merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të regjistruar në pasqyrat financiare. Ne gjithashtu e marrim parasysh deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ (ZKA) dhe Zyrtari Kryesor Financiar (ZKF), kur draft PVF-të të dorëzohen në Qeveri.

Deklarata në lidhje me prezantimin e PVF-ve përfshin një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese dhe cilësinë e informacionit në kuadër të pasqyrave vjetore financiare. Disa deklaratë kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

Konkluzioni i përgjithshëm

Cilësia e PVF-ve në përgjithësi ishte e mirë. PVF-të kanë përmbushur kërkesat e SNKSP "Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të Parasë së Gatshme" dhe Rregullës Financiare nr. 03/2013. Ato ofronin informata të sakta dhe të plota në lidhje me ngjarjet dhe transaksionet e prezantuara. Të gjitha obligimet e tjera për raportim të jashtëm që nuk ndërlidhen me PVF-të ishin përmbushur.

2.1 Opinioni i Auditimit

Opinioni i Auditorit të Përgjithshëm është:

Opinion i Pamodifikuar

Sipas opinionit tonë pasqyrat financiare prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale (SNISA 200/1700 Opinion i Pamodifikuar).

2.2 Pajtueshmëria me PVF dhe kërkesat tjera për raportim

Përshkrimi

PVF-të duhet të jenë në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr. 03/2013;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048 dhe ndryshim plotësimet e tij; dhe
- Kërkesat e rregullores 01/2013/MF - Shpenzimi i parave publike dhe rregullores MF-nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare të organizatave buxhetore.

Në kontekst të PVF-ve, ne nuk kemi asnjë çështje për të ngritur në lidhje me këto.

3 Rekomandimet e vitit paraprak

Konkluzioni i përgjithshëm

AAC ka implementuar rekomandimin e dhënë në raportin e auditimit për vitin 2013.

Përshkrimi

Raporti ynë i auditimit për PVF-të e vitit 2013 të AAC-së ka rezultuar më një (1) rekomandim. Gjatë vitit 2014, AAC-ja ka implementuar rekomandimin e dhënë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimit dhe të adresimit të tij, shih Shtojcën II.

Rekomandimi

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

4 Qeverisja

4.1 Konkluzioni i përgjithshëm

Menaxhmenti i AAC kishte dizajnuar një sistem të mirë të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit financiar. Kontrollat efektive kanë siguruar që menaxhimi i buxhetit të bëhet në pajtueshmëri me parimet e mirëfillta të menaxhimit financiar me përjashtim të disa dobësive të cekura në këtë raport.

Aspektet kyçe të kornizës së qeverisjes janë adresuar nga AAC –së. Vetëvlerësimi, është përgatitur dhe dorëzuar me kohë në të cilën janë paraqitur komponentët e caktuara të menaxhimit financiar dhe kontrollit. Me gjithatë, ne kemi ngritur çështje në lidhje me raportimin jo të duhur për vetëvlerësim.

Ne po ashtu kemi gjetur se, ndërkohë që realizimi i buxhetit është në nivel të duhur, por që klasifikimi i shpenzimeve duhet përmirësuar. Në anën tjetër, kontrollat mbi të hyrat janë të mira me përjashtim të aplikimit të tarifave për dhënie të licencave. Ndërsa kontrollat mbi fushën e prokurimit dhe shpenzimeve janë adekuate. Fushat kryesore ku nevojiten më shumë përmirësime janë ndarja e detyrave, avancimi i stafit dhe trajtimi i kontratave për shërbime të veçanta.

4.2 Qeverisja e mirë

Përshkrim

Menaxhmenti ka zbatuar një sërë kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet financiare funksionojnë siç duhet. Është e rëndësishme që ato të përfshijnë raportimin e duhur tek menaxhmenti për të mundësuar një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuar me përjashtim të disa dobësive të cekura në këtë raport.

Çështja 1 - Përgatitja e raportit për vetëvlerësim dhe kontrole të brendshme – Prioritet i mesëm

- E gjetura** Pyetësi i vetëvlerësimit për sistemin e menaxhimit financiar dhe kontrollit i plotësuar nga AAC, paraqiste gjendjen e funksionimit të Bordit të Drejtorëve dhe Komitetit të auditimit të cilat aktualisht nuk ekzistojnë në organizatë¹.
- Rreziku** Përpilimi i raportit të vetëvlerësimit me informata jo të sakta reflekton në dobësi apo në pajtueshmëri jo të plotë të raportimit.
- Rekomandimi 1** Drejtori i përgjithshëm i AAC-se të siguroj se kryerja e procesit të vetëvlerësimit dhe raportimi është bazuar në gjendjen reale duke e konsideruar si pjesë e përpjekjeve të veta në drejtim të zhvillimit të mëtutjeshëm të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Çështja 2 - Ndarja e detyrave - Prioritet i mesëm

- E gjetura** Sipas rregullores nr.02-2013 për “Menaxhimin e pasurisë jo financiare” specifikon se detyrat e zyrtarit të pasurisë dhe zyrtarit të pranimit/Logjistikës nuk mund t’i kryejë i njëjti zyrtar. Megjithatë, Zyrtari i Pasurisë njëkohësisht mban edhe pozitën e Zyrtarit të Pranimit/Logjistikës dhe Depoistit.
- Rreziku** Ushtrimi i detyrës në dy pozita të ndërlidhura, paraqet rrezik për mos funksionimin e kontrollit të brendshëm, raportimit si dhe përgjegjësisë në detyrë.
- Rekomandimi 2** Drejtori i Përgjithshëm të konsiderojë që detyrat e Zyrtarit Pasurisë dhe Zyrtarit të Pranimit/Logjistikës duhet të jenë të ndara, dhe të kryhen nga zyrtarë jo të njëjtë.

¹ Bordi i Drejtorëve në AAC që nga Shtatori i vitit 2013 u ka skaduar mandati, derisa AAC nuk ka të themeluar NjAB-në e as Komitetin e Auditimit.

4.3 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Përshkrimi

Ne kemi shqyrtuar burimin e fondeve buxhetore për AAC-në, shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike dhe inkasimin e të hyrave për buxhetin e Kosovës. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore – realizimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ²	2014 Realizimi	2013 Realizimi	2012 Realizimi
Burimet e Fondeve:	783,000	841,375	822,116	729,460	731,568
Granti i Qeverisë -Buxheti	783,000	841,375	822,116	729,460	731,568

Buxheti final është më i lartë se buxheti fillestar për 58,375€. Financimi i buxhetit të AAC-së është bërë vetëm nga granti qeveritar.

Në vitin 2014, AAC-ja ka përdorur 98% të buxhet final ose 841,375€, me një rritje prej 13% krahasuar me vitin 2013. Ekzekutimi i buxhetit është në nivel të kënaqshëm.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike- realizimi ndaj buxhetit(në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2014 Realizimi	2013 Realizimi	2012 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	783,000	841,375	822,116	729,460	731,568
Pagat dhe Mëditjet	492,508	594,457	594,457	459,035	379,386
Mallrat dhe Shërbimet	274,330	235,856	220,039	258,700	339,108
Shërbimet komunale	16,162	11,062	7,619	11,725	13,074

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë dhënë si në vijim:

- Rritja e buxhetit për Paga dhe Mëditje me 101,979€ është si rezultat i ngritjes së pagave me vendim të qeverisë nr.01/176 në vlerë prej 25%.
- Shkurtime buxhetore në kategorinë mallrave dhe shërbimeve në vlerë 38,473€ dhe në kategorinë e komunalive në vlerë 5,100€ janë si rezultat i zbatimit të Vendimit të Qeverisë nr 07/172 si kursime në masën 15% të buxhetit të alokuar nga këto kategori.

² Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi që është e përshtatur vazhdimisht nga Ministria e Financave

Çështja 3 – Regjistrimi i pageses në kodin ekonomik jo adekuat – Prioritet i mesëm

- E gjetura** Një pagesë në vlerë 1,769€ për furnizim me IT (llap-top, kompjuter dhe printer) është regjistruar në kodin ekonomik 13610 furnizim për zyrë ndërsa do të duhej të ishte regjistruar në 13503 kompjuterë (me pak se 1000 euro).
- Rreziku** Mos klasifikimi i shpenzimeve sipas planit kontabël të përcaktuar nga thesari, rezulton në pasqyrim të pasaktë të shpenzimeve.
- Rekomandimi 3** Drejtori i përgjithshëm i AAC-së duhet të sigurojë kontrolle shtesë në kuadër të sektorit të pagesave, në mënyrë që shpenzimet të klasifikohen dhe regjistrohen në përputhje me planin kontabël të miratuar.

Tabela 3. Të hyrat e inkasuara për buxhetin e Kosovës – realizimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2014 Pranimet	2013 Pranimet	2012 Pranimet
Të hyrat Vetanake	1,500,000	1,500,000	1,368,556	1,656,541	1,498,150
Totali	1,500,000	1,500,000	1,368,556	1,656,541	1,498,150

Në raport me planifikimin të hyrat ishin për afro 9% më pakë, ndërsa në raport me të hyrat e vitit 2013 janë zvogëluar rreth 17%. Kjo ka rezultuar si rezultat i zvogëlimit të numrit të udhëtarëve i cili ishte afër 14% më i vogël dhe nga rënia e trafikut që u përcoll gjatë vitit 2014 për shkak të ndërprerjes së fluturimeve nga një kompani ajrore në tetor të vitit 2013.

4.4 Të hyrat vetanake

Përshkrimi

Burim kryesor i të hyrave të AAC janë të hyrat nga tarifat për sigurinë e pasagjerëve, si dhe nga lëshimi i licencave dhe certifikatave. Tarifa e sigurisë së udhëtarëve që udhëtojnë me fluturime komerciale nga Kosova është përcaktuar me Rregulloren 2008/7, ndërsa përcaktimi i tarifës për dhënien e licencave/certifikatave me Rregulloren 07/2011.

AAC kishte planifikuar të arkëtojë gjatë vitit 2014 të hyra në vlerë 1,500,000€, ndërsa kishte arkëtuar 1,368,556€, apo 91%.

Çështja 4 - Lëshimi i licencave në mungesë të kryerjes së obligimit financiar - Prioritet i lartë

- E gjetura** Janë lëshuar gjashtë licenca për kontrollorët e trafikut Ajror në Aeroportin e Prishtinës, në total 1,200€. Faturimi për këto licenca është bërë, mirëpo nuk është pranuar pagesa.
- Sipas rregullorës nr.07/2011 pagesa duhet të bëhet brenda 7 ditëve nga lëshimi i licencës. Në të kundërtën, zbatohen gjobat dhe përlllogaritë interesi. Megjithatë, kjo rregullore nuk precizon shumën e gjobës, apo normën e interesit të cilën përfituesit e licencave i detyrohen në rast të vonesës së pagesës së faturave.
- Rreziku** Rritet rreziku që llogaritë e arkëtueshme të rriten, duke pasur parasysh mos pagesën e tarifës për licenca nga përfituesit. Për faktin se gjobat dhe normat e interesit nuk janë përcaktuar në rregulloren 07/2011, kjo mund të ndikojë në efikasitetin e arkëtimit të të hyrave.
- Rekomandimi 4** Drejtori i Përgjithshëm të rishikoj rregulloren duke specifikuar penalitetet dhe normat e interesit të cilat do të aplikohen në rast të vonesës së pagesave.

4.5 Shpenzimet

4.5.1 Prokurimi

Përshkrimi

AAC-ja kishte planin e prokurimit dhe e ka raportuar me kohë. Ka nënshkruar pesëmbëdhjete (15) kontrata. Për tu siguruar se janë zbatuar procedurat dhe i është përmbajtur dispozitave të ligjit të prokurimit publik ne kemi testuar pesë kontrata. Testimet kanë përfshirë tërë procesin e prokurimit, nga inicimi i aktiviteteve të prokurimit e deri në menaxhimin dhe realizimin e kontratave dhe të pagesave. Vërehet se ka një kontroll adekuate të këtyre proceseve dhe nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

4.5.2 Shpenzimet jo përmes prokurimit

Përshkrim

Shpenzimet tjera janë shpenzimet që nuk kalojnë përmes procedurave të prokurimit. Këtu bëjnë pjesë shpenzimet komunale, drekat zyrtare, udhëtimet zyrtare, etj.

Ne kemi testuar disa mostra te nevojshme të këtyre shpenzimeve. Duken se kontrollet janë adekuate dhe ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

4.5.3 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)

Përshkrimi

Kemi rishikuar listat e pagave si dhe kemi krahasuar të dhënat e prezantuara nga Thesari, SIMFK dhe prezantimin e tyre në PVF. Po ashtu kemi testuar disa mostra duke përfshirë dosjet e personelit dhe procedurat e rekrutimit për këtë periudhë. Numri i stafit të lejuar për AAC sipas buxhetit është 27, ndërsa aktualisht janë 27 punëtorë të rregullt dhe një punëtorë me orar të shkurtuar. Numri më i madh i personelit se që është planifikuar ishte për arsye se në muajin shkurt, me vendim të Qeverisë është emëruar Zëvendësdrejtori i Përgjithshëm i AAC-së.

Çështja 5 - Paguesa për kontrate mbi shërbimet e veçanta - Prioritet i mesëm

E gjetura AAC-së nga viti 2013 ka kontratë mbi vepër me një zyrtare për përkrahje profesionale teknike në Departamentin e Sigurisë së Fluturimeve. Kjo kontratë vazhdohet çdo pesë muaj dhe kompensimi bëhet nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve.³ Gjithashtu, për qëllime trajnimi të personelit të AAC-së të organizuara nga Organizata Trajnuese e Autoriteteve të Përbashkëta të Aviacionit (JAA-TO), AAC ka angazhuar këtë zyrtare duke kompenzuar vlerën 2,436€.

Rreziku Vazhdimi i kontratës mbi shërbimet e veçanta, ndikon në performancën e stafit si dhe në cilësinë e shërbimeve administrative. Mbulimi i shpenzimeve të udhëtimeve për personel jo të rregullt krijon paqartësi që mund të ndikoj negativisht në performancën e stafit tjetër apo në aspektin e trajtimit të tyre.

Rekomandimi 5 Drejtori i Përgjithshëm të konsideroj nevojat e organizatës për pozitat e përhershme dhe të shqyrtohet mundësia e rekrutimit të rregullt të stafit. Shpenzimet e udhëtimit të mbulohen vetëm për zyrtaret të cilët kanë marrëdhëniet të punësimit të rregullt në këtë institucion.

³ Sipas Ligjit të Shërbimit Civil, emërimet me afat të caktuar për një periudhë më të shkurtër se gjashtë (6) muaj do të bëhen në bazë të kontratave për "Marrëveshje për shërbime të veçanta" të cilat i nënshtrohen Ligjit për Detyrimet dhe për të cilat zbatohet një procedurë e thjeshtësuar e rekrutimit.

Çështja 6- Avancimi në pozite - Prioritet i mesëm

- E gjetura** AAC-se kishte avancuar ne pozitë të inspektorit një zyrtar ende pa e përfunduar punën provuese⁴. Sipas menaxhmentit te AAC-së zyrtari ka arritur kualifikimet e nevojshme profesionale dhe kushtet përkatëse për ngritje ne gradën e inspektorit bazuar ne përvojën nga puna paraprake ne aeroport.
- Rreziku** Kjo situatë mund të rezultojë që zyrtari i avancuar të mos jetë në gjendje që në tërësi t'i përmbushë objektivat për pozitën e kërkuar.
- Rekomandimi 6** Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë që avancimet në pozitë janë të arsyeshme, të justifikueshme dhe për qëllim të arritjes së objektivave në pozitat e caktuara. Njëkohësisht, të sigurojë që kjo të ndodhë duke marrë në kosiderim rregullat dhe procedurat përkatëse.

4.6 Pasuritë dhe detyrimet

4.6.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Përshkrim

Vlera e pasurive jo-financiare në posedim të AAC-së është 38,246€. Kjo shumë përfshinë pasuritë mbi 1,000€ me vlerë 7,239€, pasuritë nën 1,000€ me vlerë 24,075€ dhe stoqet me vlere 6,932€.

AAC ka zyrtarin e pasurisë, i cili njëkohësisht është edhe zyrtarë i pranimit/logjistikës.

Bordit të Drejtorëve ju ka skaduar mandati, megjithatë, mjetet e punës që janë pasuri e AAC-së ende janë në shfrytëzim të tyre.

⁴ Sipas ligjit të Shërbyesve Civil, të gjithë kandidatët që pranohen në Shërbimin Civil në pozitat e karrierës emërohen në punë provuese me kohëzgjatje dymbëdhjetë (12) muaj. Në përfundim të periudhës së punës provuese, eprori i drejtpërdrejtë në bazë të vlerësimit pozitiv të performancës, mbështetur në rezultatet në punë të nëpunësit civil, vendos konfirmimin ose jo të tij në atë pozitë pune.

Çështja 7 - Mungesë e kthimit të pasurive - Prioritet i mesëm

- E gjetura** Bordi i drejtorëve prej pesë anëtarëve, gjatë mandatit të tij ishte i ngarkuar me mjete pune (llaptop dhe telefona mobil) për kryerjen e detyrave zyrtare. Bordit i kishte skaduar mandati dhe tani nuk janë aktivë, derisa mjetet e punës nuk i kshin kthyer ende.
- Rreziku** Mos kthimi i mjeteve nga ish anëtarët e bordit paraqet keqpërdorim të aseteve institucionale për qëllime private dhe mund të cilësohet si përvetësim i tyre, duke shkaktuar dëme materiale ndaj AAC-së.
- Rekomandimi 7** Drejtori i Përgjithshëm të sigurohet që janë marrë masa shtesë duke ju përkujtuar poseduesve të pasurisë procedurat dhe kërkesat ligjore për shfrytëzim dhe kthimin e pasurisë.

Çështja 8 - Mungesë e regjistrimit E-Pasuria - Prioritet i mesëm

- E gjetura** AAC ende nuk ka në funksion sistemin elektronik të menaxhimit për materialin shpenzues E-pasurisë⁵. Regjistrimi i materialit shpenzues menaxhohet përmes listave që gjenden në depo.
- Rreziku** Në mungesë të regjistrimit E-pasuria, informata e prezantuara nuk do të jenë në përputhje me formatet standarde të kërkuara, andaj të dhënat e prezantuara mund të jenë konfuze sidomos sa i përket materialit shpenzues.
- Rekomandimi 8** Drejtori i përgjithshëm i AAC-se duhet të sigurojë se është vë në funksion sistemi e-pasuria dhe se janë bërë gjitha regjistrimet e nevojshme në sistem.

4.6.2 Trajtimi i të arkëtueshmeve

Përshkrim

Të arkëtueshmet e AAC-së të paraqitura në PVF-te e vitit 2014, janë 198,212€ për faturat e muajit nëntor, dhjetor 2014 dhe një obligim për licencim. Këto ndërlidhen më memorandumin e lidhur në mes të AAC-së dhe Kompanisë “Limak Kosova”, sipas të cilës mjetet transferohen në llogarinë e AAC-së 45 ditë pas përfundimit të çdo muaji.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime ne këtë fushe.

⁵ Sipas Rregullores për Menaxhimin e Pasurive, çdo organizatë buxhetore duhet mbajë regjistrin E-pasuria, për evidentimin e pasurive me vlerë nën 1,000€.

4.6.3 Trajtimi i borxheve

Përshkrim

Pasqyra e detyrimeve të papaguara ndaj furnizuesve në fund të vitit 2014 ishte në shumën 3,630€. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2015.

Rekomandimet

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

4.7 Sistemi i auditimit të brendshëm

Përshkrimi

Sipas U.A. nr.23/2009 për themelimin e Njesisë së Auditimit të Brendshëm (NJAB) , AAC nuk i plotëson kushtet për themelimin e kësaj njësie andaj auditimi i brendshëm në AAC mund të realizohet përmes njesisë së auditimit të brendshëm në kuadër të Ministrisë së Financave.

Ndërsa për vlerësim të efektiviteteve të kontrolleve të brendshme dhe me qëllim të akreditimit të sistemit të menaxhimit të cilësisë në organizatë, Drejtori i Përgjithshëm ka formuar zyrën për auditim të brendshëm dhe kontrollim të cilësisë (ZABKC)⁶. Kjo është përgjegjëse për monitorimin e përmbushjes së vazhdueshme të standardeve të cilësisë.

Çështja 9 – Auditimi i brendshëm dhe menaxhimi i kontrollit të cilësisë – Prioriteti i lartë

E gjetura	<p>Departamenti i NJAB në kuadër të MF-së gjatë vitit 2013 ka kryer një auditim të brendshëm që ka përfshirë fushëveprimin për vitin 2012 dhe gjashtëmuorin e parë të vitit 2013, viti 2014 nuk është audituar fare.</p> <p>Në anën tjetër, objektivat dhe fushëveprimi i ZABKC duket se janë mjaft sfiduese, duke marrë në konsiderim konkluzionet dhe raportimin ndaj menaxhmentit të AAC-së.</p>
Rreziku	<p>Në mungesë të kryerjes së auditimit të brendshëm, dobësitë dhe mangësitë eventuale të kontrollit të brendshëm mund të jenë prezente dhe të paevituara.</p> <p>Derisa, objektivat dhe sfidat që ka ZABKC, mund të mos ofrojnë menaxhmentit nivelin e duhur të sigurisë në efikasitetin e kontrolleve të brendshme.</p>
Rekomandimi 9	<p>Drejtori i Përgjithshëm duhet të konsideroj auditimin e brendshëm përmes NJAB-së tjetër të mundëshme. Në anën tjetër, të rishikoj fushëveprimin e ZABKC-së se ka një plan të realizueshëm dhe efektiv për të arritur objektivat e AAC-së.</p>

⁶ Auditimi i brendshëm i sistemit të menaxhimit të cilësisë bëhet në Autoritetin e Aviacionit Civil dhe nuk ka lidhje me auditimin e brendshëm financiar në kuptimin e Ligjit për Auditim të Brendshëm.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinionëve të aplikuar nga ZAP

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë anomali materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për ‘Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit’.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale. Auditorët mund të japin tre lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- Natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë anomali materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë anomali materiale; dhe
- Gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomalitë, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomalitë, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban anomali materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i Theksimit të Çështjes duhet:

- Të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- Të ketë titullin 'Theksim i Çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- Të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen;
- Të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak

Komponenti i Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Rekomandimet plotësisht të adresuara	Rekomandimet pjesërisht të adresuara	Rekomandimet e pa adresuara
4.5.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale	Drejtori i Përgjithshëm i AAC-së duhet të siguroj se është azhurnuar regjistri i pasurisë (E-pasuria) duke larguar pasuritë me vlerë mbi 1,000€.	E implementuar		